

MIKROSKOPI DIGJITAL

DIGITAL MICROSCOPE



Mikroskopi është instrument optik i cili përdoret për hulumtimin e objekteve të vogla, siç janë mostra të mineraleve, qeliza shtazore ose bimore, duke zmadhuar pamjen në qindra ose mijëra herë.

Mikroskopi gjithashtu mund të përdoret për elektronike, duke dhënë mundësi të hulumtimit të qarqeve elektrike fizikisht.

Mikroskopi digjital është variant i mikroskopit optik tradicional i cili përdor optikën dhe kamerën digjitale për të paraqitur imazhet në monitor, ndonjëherë me anë të softuerit që ekzekutohet në kompjuter.

Mikroskopët digjital shpesh kanë burimin e vet të ndriçimit të integruar, dhe dallohet nga një mikroskop optik sepse nuk ka ndonjë hapësirë për të vëzhguar mostrën drejtpërsëdrejti përmes një okulari, andaj i gjithë sistemi është i dizajnuar për të projektuar imazhin në monitor.

Anatomia e mikroskopit digjital




Puna me mikroskopin digjital

Me anë të mikroskopit digjital ne mund të ruajmë fotografi ose video të shkurtër në SD kartë. Nuk kemi nevojë për kompjuterë për të realizuar incizimet.

Informacione për kamerën digjitale dhe interaksionin me ekran

Te flasim pak rreth ekranit touch-screen, dhe interaksionit me të. Në figurën më poshtë e kemi ekranin dhe numrat rreth secilës ikonë.



Tash po e japim një përshkrim të shkurtër për secilën funksionalitetin prapa secilit ikonë

1 >> Rritja e funksionit EV	5 >> Përzgjedhja
2 >> Zmadhimi dhe zvogëlimi i ekranit	6 >> Navigimi i opsioneve
3 >> Kthim nga menyja, dhe kalimi ne video mode	7 >> Navigimi i opsioneve
4 >> Konfigurimi	8 >> Butoni "on/off"



SHENIM: Pasi që ndalim LCD Monitorin, shumica e konfigurimeve kthehen ne konfigurimet baze.

Video Mode


Modi për incizimin e videove, duket kështu:



Butonat në imazhin e mësipërm e bëjnë të njëjtën punë sikur në modin e fotografimit.

Rishikimi i fotografimeve ose videove



Prej Video Mode klikojmë ikonën e videos . Në këtë mod ne mund të shikojmë videot/fotografitë e realizuara më parë. Vetëm klikojmë shigjetat për të naviguar në fotografitë/videot e realizuara, si dhe për t'i fshirë ato nëse zgjedhim.

KUJDESI DHE MIREMBAJTJA

Mikroskopi digjital duhet të mirëmbahet me kujdes gjatë gjithë kohës. Përcillni këto sugjerime dhe do të keni nevojë minimale për mirëmbajtje:

1. Kur e përfundoni përdorimin e mikroskopit, largoni mostrën nga hapësira vëzhguese
2. Ndalini të gjithë ndriçuesit (të sipërm dhe të poshtëm)
3. Ndaleni LCD Monitorin - Shtypni butonin on/off derisa e shihni "Shutting Power Off"
4. Largojeni nga priza
5. Gjithmonë mbulojeni mikroskopin me qese të plastikes ose mbulesa të pluhurit gjatë kohës që nuk e përdorni, kjo e ndihmon të mbetet mikroskopi i pastër.
6. Mbajeni mikroskopin në një hapësire të thatë dhe të pastër.
7. Të keni kujdes të shtuar kur e përdorni mikroskopin drejtpërdrejt me dritën e diellit, sepse mund të dëmtojë mikroskopin ose sytë tuaj

8. Kur e lëvizni mikroskopin, barteni me njëren dorë tek “Doreza” dhe dorën tjetër nën bazë për mbështetje.
9. Pastrojini sipërfaqet e jashtme (metalike dhe plastike) me një leckë të lagur
10. Gjithmonë çkyçeni të gjitha kabllot para pastrimit
11. Asnjëherë mos i pastroni sipërfaqet optike me leckë apo letër sepse mund të gërvishten shumë lehtë.
12. Për të pastruar gishtërinjtë nga sipërfaqja optike, përdorni lecka speciale për pastrimin e lenteve, të cilat mund t’i blini në të gjitha shitoret e fotografisë apo optikës.
13. Asnjëherë mos i pastroni pjesët e brendshme optike, kjo duhet të realizohet nga profesionistë.

Ide për njësi mësimore

Aktivitete dhe njësi mësimore të ndryshme rreth përdorimit të mikroskopit digjital në grupmosha të ndryshme:

- https://www.bugsandbiology.org/uploads/7/5/2/5/7525114/digital_scope_ebook.pdf
- <http://faculty2.ric.edu/mkniseley/eled437/smallwonderscloseencounters-excerpt.pdf>